

ÇFARË ËSHTË MATËSI INTELIGJENT DHE SI FUNKSIONON AI?

Matësit inteligjentë janë matës të gjeneratës tjetër si për konsumin e gazit ashtu edhe për energjinë elektrike. Ato janë një zëvendësim i matësve standartë, të cilët ju lejojnë që të gjurmoni leximet tuaja të matësve dhe t'i paraqisni ato tek furnizuesi juaj për të siguruar fatura të sakta.

Matësit inteligjentë përdorin një rrjet të sigurt kombëtar të komunikimit për të dërguar automatikisht dhe pa tel, konsumin aktual të energjisë tek furnizuesi juaj.

Matësit inteligjentë gjithashtu mund të vijnë me një ekran në shtëpi. Ky ekran ju jep informacione për përdorimin në kohë reale, përfshirë përdorimin dhe koston e kWh.

Si për çdo gjë, matësit inteligjentë kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre.

Përfitimet e Matësit inteligjent:

Fatura më të sakta

Matësit inteligjentë nënkuptojnë fundin e faturave të pritshme, fundin e nevojës që të siguroni lexime të matësit dhe / ose të prisni lexuesin në shtëpinë tuaj për të lexuar konsumin e muajit.


Kuptim më i mirë i përdorimit tuaj

Me ekranin e matësit inteligjent, ju mund të shihni ndikimin e drejtpërdrejtë të zakoneve dhe stilit të jetës tuaj në faturën tuaj. Duke e bërë përdorimin tuaj të energjisë më të lehtë për tu kuptuar, ju mund të merrni vendime më të mençura për të kursyer energji dhe para.

Disavantazhet e Matësve Inteligjentë

Të mbetesh "i shurdhët"

Duke qenë teknologji në zhvillim mund të kenë nevojë për përditësim. Problematika e matësve inteligjent është se mund të humbasin funksionalitetin në moment kur vendosni të ndryshoni furnizuesin tuaj, në të cilin paisja është instaluar ose lidhur.



A mund ta ndryshoj furnizuesin e energjisë nëse kam një matës inteligjent?

Përgjigja e shkurtër është **PO**.

A do të më kursejë para një matës inteligjent?

Një matës inteligjent në vetvete nuk do t'ju kursejë para, por të dhenat të cilat do të vijnë nga matësi inteligjent mund të ofrojnë shumë njohuri se si të ulni faturat. Ekрани juaj në shtëpi ju lejon të shihni se sa energji po përdorni në kohë të ndryshme të ditës, javë, muaj ose vit, gjë që mund t'ju ndihmojë të ulni përdorimin e energjisë dhe faturat tuaja.

A duhet të kem një matës inteligjent?

JO. Matësit inteligjent nuk janë të detyrueshëm dhe nuk keni asnjë detyrim që të keni të instaluar një matës inteligjent në shtëpinë tuaj.

A janë të sigurt matësit inteligjentë?

Të gjithë matësit inteligjentë i nënshtrohen rregullave të njëjta të sigurisë dhe testimit të çdo pajisjeje teknologjike në shtëpi, përfshirë monitorët e foshnjave dhe telefonat mobil.

Matësit inteligjent janë gjithashtu të mbuluar nga legjislacioni i sigurisë së BE dhe MB, që do të thotë se ata i janë nënshtruar një testimi rigoroz.

Matësit inteligjent lëshojnë emisione të ulta të frekuencës radio në të njëjtën mënyrë si pajisjet e tjera pa tel. Këto lejojnë furnizuesit e energjisë të gjurmojnë saktë konsumin e energjisë familjare dhe do t'i japin fund faturave të pritshme.

Si të lexoni një matës inteligjent

Një nga përfitimet kryesore të matësve inteligjent është se nuk keni pse të siguroni lexime të rregullta të matësve tuaj të energjisë. Sidoqoftë, nëse matësi juaj ka humbur funksionalitetin e tij inteligjent ose dëshironi të lexoni për ndonjë arsye tjetër, është e mundur ta bëni këtë.

